

VENDIM
Nr. 193, datë 20.11.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E LICENCËS TIP PËR
VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË HAPËSIRAT E DEPOZITIMIT TË GAZIT
NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të seksionit II, neni 22, 23, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe të nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 123/1 prot., datë 19.11.2020, për fillimin e procedurës për miratimin e licencës TIP për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike;

konstatoi se:

- Në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, ERE ka kompetencën për të hartuar licencën TIP në veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror.

- ERE ka hartuar draftin bashkëlidhur, duke përcaktuar kushtet, afatet apo të drejtat e detyrimit e të licencuarit, mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

- Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është organi i ngarkuar nga ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, me të drejtën për të dhënë licencë të operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror.

- Të licencuarit që fitojnë të drejtën për të ushtruar aktivitetin e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, janë subjekt të kushteve të kësaj licence, si dhe të kushteve të përcaktuara në vendimin e Bordit të ERE-s për licencimin.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën, për miratimin e licencës TIP, për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror.

2. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti